



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA
(ADISA)

NJOFTIM MBI RUAJTJEN E PRIVATËSISË

TABELA E PËRMBAJTJES

1. SI I PËRDORIM NE INFORMACIONET TUAJA	3
2. PERSONAT QË PARAQESIN NJË ANKESË PRANË ADISA-s	3
3. VIZITORËT NË FAQEN TONË TË INTERNETIT	3
4. TË PUNËSUARIT AKTUAL DHE ISH PUNONJËSIT E ADISA-S	4
5. AKSESI NË TË DHËNAT PERSONALE	4
6. LIDHJET ME FAQET E TJERA	4
7. ANKESA APO PYETJE	4
8. SI TË NA KONTAKTONI	4
9. POLITIKA E SIGURISË SË INFORMACIONIT	5

1. SI I PËRDORIM NE INFORMACIONET TUAJA

Ky njoftim mbi ruajtjen e privatësisë tuaj ju tregon se çfarë duhet të prisni kur Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (në vijim ADISA), të mbledhë të dhënat tuaja personale. Kjo vlen për informacionin e mbledhur në lidhje me:

- a. Ankuesit të cilët paraqesin ankesa lidhur me veprimtarinë e sportelit të shërbimit ose me veprimtarinë e zyrave përgjegjëse për shërbimin.
- b. Individët e tjerë të cilët paraqesin kërkesa të ndryshme për marrje informacioni, etj.
- c. Kandidatët për punësim, punonjësit aktual të ADISA-s, si dhe ish-punonjësit.
- d. Vizitorët në faqen tonë.

2. PERSONAT QË PARAQESIN NJË ANKESË PRANË ADISA-s

Çdo ankesë që depozitohet pranë ADISA-s, protokollohet nga punonjësi i arkivës. Këto ankesa shqyrtohen në përputhje me Ligjin Nr. 13/2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”.

ADISA përdor të dhënat personale që mbledhim vetëm për procesin e shqyrtimit të ankesës. ADISA përpilon dhe publikon statistika duke treguar informacione të tilla si numri i ankesave që marrim, por jo në një formë që të identifikojë ndonjërin prej tyre.

ADISA mban të dhëna personale të përfshira në dosjet e ankesave në përputhje me ligjin dhe politikën tonë të ruajtjes së të dhënave personale. Ato mbahen në një mjedis të sigurt dhe aksesit në të është i kufizuar në bazë të parimit “nevoja për të ditur dhe njohur”.

3. VIZITORËT NË FAQEN TONË TË INTERNETIT

Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) disponon faqen zyrtare të internetit www.adisa.gov.al. Nëpërmjet kësaj faqeje, ADISA u vjen në ndihmë individëve dhe jo vetëm, duke dhënë informacion mbi shërbimet publike, shtrirjen e ADISA-s në territor, si dhe duke iu dhënë informacione të tjera të dobishme.

Për vizitorët e www.adisa.gov.al sistemi mbledh informacione standarde të cilat kanë të bëjnë me klikimet e artikujve apo rubrikave në këtë faqe. Ky informacion mblidhet për qëllime statistikore dhe studimi (për të treguar qasjen e vizitorëve, për të parë se cilat janë rubrikat më të ndjeshme, gjithnjë pa i bërë ata të identifikueshëm).

Ky informacion mblidhet në atë mënyrë që të mos identifikojmë asnjë vizitor, si dhe nuk bëhet asnjë përpjekje për të gjetur identitetin e vizitorëve që kanë vizituar faqen tonë të internetit.

ADISA nuk përdor (dhe nuk lejon ndonjë palë të tretë) mjete statistikore analitike për të ndjekur ose për të mbledhur informacione personale që i bëjnë të identifikueshëm vizitorët e faqes tonë zyrtare. Asnjë e dhënë të grumbulluar nga kjo faqe nuk lidhet me ndonjë të dhënë personale që e bën vizitorin të identifikueshëm nga çdo burim që të vijë, si pjesë e përdorimit tonë.

Nëse do të duam të mbledhim informacione personalisht të identifikueshme nëpërmjet faqes sonë të internetit, do t`jua bëjmë të qartë rastin kur të mbledhim informacion personal dhe do të shpjegojmë se çfarë kemi ndërmend të bëjmë me të.

4. TË PUNËSUARIT AKTUAL DHE ISH PUNONJËSIT E ADISA-S

Për çdo punonjës të ADISA-s, përgatitet dosja përkatëse, e cila ruhet dhe administrohet nga strukturat përgjegjëse të burimeve njerëzore. Të dhënat e përfshira në të, mbahen të sigurta dhe përdoren vetëm për qëllime që lidhen drejtpërdrejtë me punësimin e personit.

Kur marrëdhënia e punës me ADISA-n përfundon, ADISA ruan dosjen në përputhje me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, ligjin për arkivat dhe rregulloren e brendshme të institucionit.

5. AKSESI NË TË DHËNAT PERSONALE

ADISA përpiqet të jetë sa më i hapur për t'i dhënë individëve akses në të dhënat e tyre personale. Individët mund të zbulojnë nëse mbahet ndonjë e dhënë personale, duke dërguar një “kërkesë për akses tek të dhënat personale” në bazë të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Nëse institucioni mban të dhënat tuaja personale, do të:

- a. Jepet një përshkrim të tyre;
- b. Bëhet me dije se përse ne i mbajmë ato;
- c. Tregohet se te cili marrës mund ti përhapim këto të dhëna;
- d. Jepet një kopje të informacionit në një formë të kuptueshme;
- e. Informohet nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare.

Për të bërë një kërkesë pranë ADISA-s, për çdo të dhënë personale që mund të mbahet, është e nevojshme të bëni një kërkesë me shkrim drejtuar institucionit tonë ose t'a dërgoni në adresën informacion@adisa.gov.al.

Nëse jeni dakord, ne do të përpiqemi të merremi me kërkesën tuaj në mënyrë jo formale, për shembull duke iu dhënë informacionin specifik nëpërmjet telefonit.

6. LIDHJET ME FAQET E TJERA

Ky njoftim mbi ruajtjen e privatësisë për të arritur mbrojtjen e të dhënave personale nuk përfshin lidhjet midis kësaj faqeje dhe faqeve të tjera. Ne ju inkurajojmë të lexoni deklaratat e privatësisë në faqet e tjera të internetit që ju vizitoni.

7. ANKESA APO PYETJE

ADISA përpiqet për të përmbushur standardet më të larta gjatë mbledhjes dhe përdorimit të të dhënave personale. Për këtë arsye, institucioni merr shumë seriozisht ankesat në lidhje me këtë temë. Gjithashtu, mirëpresim çdo sugjerim për përmirësimin e procedurave tona.

Ky njoftim mbi mbrojtjen e të dhënave personale u hartua me qëllim për të qenë i qartë dhe i shkurtër. Nuk jepen detaje të plota të të gjitha aspekteve të mbledhjes dhe përdorimit të të dhënave personale nga ana e ADISA-s. Megjithatë, ne jemi të gatshëm t'ju japim çdo informacion shtesë apo shpjegim të nevojshëm. Çdo kërkesë për këtë duhet të dërgohet në adresën e – mailit informacion@adisa.gov.al.

8. SI TË NA KONTAKTONI

Kërkesat për informacion në lidhje me politikën tonë të privatësisë mund të dërgohen me e-mail në adresën informacion@adisa.gov.al.

9. POLITIKA E SIGURISË SË INFORMACIONIT

Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) përpunon informacionin me qëllim kryerjen e detyrave të saj. ADISA është angazhuar për të siguruar përdorimin e informacionit dhe informacionin e sistemeve të teknologjisë me qëllim ruajtjen e integritetit dhe konfidencialitetit të informacionit nën kontrollin e saj.

ADISA përdor një qasje të bazuar në risk, gjatë vlerësimit dhe të kuptuarit të rreziqeve si dhe përdor të gjitha mjetet fizike të personelit, teknike dhe procedurale për të arritur masat e duhura të sigurisë. ADISA merr parasysh zhvillimet në teknologji dhe kostot e zbatimit për të arritur një nivel sigurie të përshtatshëm për natyrën e informacionit dhe të dëmit që mund të rezultojë nga një shkelje e sigurisë.

Stafi i ADISA-s i nënshtrohet detyrimit për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit i cili i jepet këtij të fundit për të ushtruar funksionet e tij në bazë Ligjit Nr. 13/2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në Republikën e Shqipërisë” dhe mund t’ua përhapë atë vetëm autoriteteve të ligjshme. ADISA i ofron udhëzime dhe trajnime stafit të tij për t’u mundësuar atyre të kuptojnë dhe të zbatojnë përgjegjësitë e tyre në respektimin e sigurisë.